




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL III/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.03.2024
Ora: 13.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese,pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2034;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedhë në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake;

Kryesuesi - e elaboron pikën 2 dhe hap debatin.

Urim Suka - sot jemi mbledhur dhe para vetës kemi vendimin për bartjen e mjeteve por për dallim nga vitete e kaluara kur bartja e mjeteve na ka ardhë si dokument i vetëm,gjatë këtij viti kjo bartje do të bëhet në pjesë sepse ju e dini që nuk kemi me i bartë 554.000 siq ka ardhë me këtë projekt-vendim por përveq kësaj shifre edhe mbi 1.500.000 tjera presin për tu bartur në mbledhjet e ardhshme besoj.E vërteta është se ne nuk kemi me i bartë 554.000 por kemi mi bartë mbi 2 milion euro që janë para të pasqepnuara që i kanë mbet këtij ekzekutivi në vitin 2023 dhe të cilat do të detyrohemi ti bartim në vitin 2024.Kur jemi te ky vendim,në disa seanca të mëhershme unë e kam ngrit shqetësimin për mos përfshirjen e propozimeve të asambleistëve me rastin e miratimit të buxhetit në seancën e jashtzakonshme të 2 shtatorit ku asambleistët kanë dhënë propozimet e veta të cilat janë votu një nga një dhe ato propozime sot nuk figurojnë askund.Gjatë këtyre shqetësimeve që unë i kam ngrit më herët, Drejtori i Financave ka dhënë

përgjigje se këto projekte kanë me hy në buxhet kur ta bëjnë bartjen e mjeteve. Unë e lexova këtë dokument dhe asnjë prej atyre propozimeve nuk është këtu. Kjo situatë për të cilën unë po flas nuk mendoj që duhet të kalohet me kaq lehtësi. Vendimet që ne si Kuvend i marrim nëse ekzekutivi i ndryshon në zyret e veta, kjo është një skandal i madh. Unë kam dëshirë me i ndëgju edhe të tjerët dhe ne si kuvend duhet ta marrim situatën në dorë dhe ta japim fjalën tonë. Unë kam dëshirë ta ndëgjoj edhe Aziz Bytyqin, shefin e grupit tuaj sepse vet është jurist dhe ky e din më së miri se çka ka nadodh me këtë vendim për të cilin unë po flas. Është tjetërsu vullneti jonë si kemi votu atë ditë dhe të gjithë po heshtin. Nëse heshtim edhe ne si kuvend për ato ndryshime që ekzekutivi i bën pa lejen tonë për vendimet që ne i marrim, atëherë ne po bëhemi pjesë e atyre shkeljeve ligjore dhe kjo është e pa precedentë.

Në këtë vendim është planifiku që përveq tjerash janë planifiku edhe 355.980€ për kolektorin në rrugën “Skënderbeu”. Të gjithë e dini që për këtë kolektor është bërë një kontratë në vlerë mbi 900.000€ por e vërteta e kësaj është që ministria nuk e ka leju zgjerimin e rrugës por i ka dhënë dritë jeshile vetëm kolektorit. A e keni zgjidh problemin me ministrinë për deri sa po vazhdoni me planifiku mjete për projektin e njejtë? Nëse nuk e keni zgjidh problemin me ministrinë pse i planifikojmë mjetet kur e dimë që nuk e kemi lejen e ministrisë për me realizu atë projekt. Ne si LDK jemi kundër fuqishëm edhe këtij vendimin që ka ardhë.

Liridon Fandaj - kërkoj sqarim nga Drejtori i Ekonomisë dhe Financave dhe nga ZKF-ja. Pjesa e mbetur e mjeteve përveq këtyre tejkalimeve, si do të shpërndahet në projekte pasi drejtori e ka dhënë një arsye që ministria e ndan? Nuk ka mundësi ministria nëse ne nuk e qojmë një dokument me i shpërnda ato në projekte. Është mirë me na sjell një dokument dhe me ditë se ku kanë me shku ato mjete që kanë tepru. Te pjesa tjetër ku është bërë shpërndarja e tejkalimit në këto projekte, këtu njëherë veq janë planifiku dhe kanë një kosto. Do të duhej të themi që këto mjete që po i bartni ose kanë dalë punë shtesë ose jemi duke i qu vetëm në projekte e mandej me i shpërnda siç është shpërnda pjesa e 400.000€ prej Drejtorisë së Bujqësisë që i kemi qu te kolektori dhe në fund të mandatit është shpërnda me vendime të Kryetarit dhe i ka tejkalu 5% të investimeve kapitale.

Kryetari - unë nuk e di ku janë ato 2 milion euro. E kemi pas takimin dhe kemi marrë pjesë në KPF ku bartjet bëhen 545.000. Vlerësimin e jep zyrtari për financa. Është e vërtetë që këtë vit nuk barten sikur vitet e kaluara mirëpo projektet që kanë mbet mjete prej vitit të kaluar shkojnë te projektet e njejtë. Te kolektori ne jemi të interesuar që ta zbatojmë ligjin që është në fuqi, të zbatojmë HZK-në, PZHK-në, Planin detal dhe Planin urban. Është e vërtetë që vitin e kaluar e kemi pas një ndalesë nga ministria, e kemi një marrëveshje dhe do ta kryejmë komplet infrastrukturën nëntokësore. Kryetari tutje jep sqarime rreth projektit të rrugës “Skënderbeu” dhe kolektorit dhe thotë që nuk punojmë pa leje asgjë sepse janë ligjet, janë organet dhe ata që nuk e zbatojnë ligjin le të përballen me drejtësinë.

Fadil Hoxha - ZKF jep sqarime sa i përket bartjes së mjeteve dhe thotë që në ligjin e buxhetit të viti 2023 Nr-08/L -193 dhe i viti 2024 Nr-08/L-260, në nenin 9 të këtij ligji ku thotë që ndarja dhe rindarja e fondeve të barten nga obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak. Në pikën 6 dhe pikën 7 që është shtu krahasuar me 2023-tën thotë: bilancet e pa shpenzuara të të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2023 dhe viteve paraprake të depozituara në fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SFMK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin 2024 sipas autorizimeve të ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike duke ruajtur strukturën e shpenzimeve. Ndërsa pika 7 thotë: të hyrat vetanake të realizuara gjatë viti 2023 dhe të regjistruara në SFMK që kalojnë shumat e të hyrave, të ndara në tabelën 4.1, për vitin 2023 barten në vitin 2024 me vendim të Kuvendit Komunal. Andaj ne kemi qenë të obliguar me marrë një hap të tillë me nda sa ka qenë buxheti i planifikuar i të hyrave vetanake, sa është bërë tejkalimi. Tejkalimi që ka qenë 554.532 duhet me u bartë me vendim të Asamblesë. ZKF tutje jep sqarime dhe thotë që bartja nuk është 2 milion por është 1.647.532€.

Liridon Fandaj - po thua bartjen e bën ministria, e bën për projektet që nuk janë shpenzu mjetet. Nëse ministria e bartë në këto projekte që ne po e bëjmë tejkalimin e mjeteve, mos po del mbi planifikimin që e kemi bërë ne sepse nëse ti nuk e din ku ka me i bartë mjetet ai, ai ka mundësi në kolektor me i qu nëse ju ka mbet pa përfund kolektori dhe ne me bartjen e mjeteve e tejkalojmë planifikimin. A na vje prap edhe një herë me bo alokimin e mjeteve dikund tjetër?

Fadil Hoxha - këto katër projektet që janë, i kemi marrë edhe mjetet që edhe nëse barten aty nuk kanë me mujt me i bartë sepse ne i kemi bërë kalkulimet tona sa janë aty dhe sa i kemi. Kemi pas për kolektor dhe mjetet kanë mbet dhe ato që kanë mbet i kemi planifikuar. 120.000 janë prej të hyrave vetanake që nuk kemi mujt me i shpenzuar. ZKF tutje jep sqarime.

Labinot Halitjaha - këto 554.000€ që janë këtu, këto nuk janë suficit por janë bartje e të hyrave që kanë ndodh në vitin 2023 që ne e kemi tejkaluar buxhetin. Të hyrat që ndodhin në nëntor dhe dhjetor ato nuk shpenzohen por dalin vitin tjetër. Duhet ta kuptosh këtë dhe mos e keqinformo opinionin sepse nuk është në rregull.

Urim Suka - u tha që ku janë ato 1.5 milion euro. Raportin e shpenzimeve që ju e keni sjell në janar figuron mbi 1.5 milion euro që nuk janë shpenzuar dhe kjo është ajo e dhënë që unë e përdora dhe e dyta e dhënë është kjo 554.000 dhe kur i bën bashkë këto e kalon 2 milionëshin. Drejtori u mundu me ma lënë një farë faji që unë po bëj keqinformim por unë pyetjen e pata konkrete. Drejtor ti m'ke thënë që propozimet e asambleistëve ke me i fut me bartje. Pse nuk më ktheve përgjigje për pyetjen që të bëra? Askund nuk e kam përmend fjalën suficit por po flas për bartje. Edhe Kryetari në përgjigjen e vet askund nuk e dha përgjigjen që unë e kërkoja. A e ke marrë pëlqimin e ministrit për me zgjeruar rrugën? Nëse nuk e ke marrë, pse po bartë mjete aty kur ti atë nuk mundesh me bërë. Përtej që po m'i devijoni fjalët, ju po i devijoni vendimet që ne po i marrim.

Kryetari - Kryetari është i interesuar me zbatuar ligjin. Ligji është më i madh se çdokush tjetër. E ceki edhe drejtori, mos ti përziejme gjërat. Ju e dini që të hyrat e mbledhura në nëntor dhe dhjetor nuk mund të shpenzohen. Të gjitha propozimet që janë dhënë në Asamble kur ka kaluar buxheti, është lista në procesverbal dhe të gjitha do ti fusim dhe do ti kryejmë. Në këtë vit fillojmë me buxhet që e kemi aprovuar vitin e kaluar.

Kryesuesi - një gjë duhet ta dallojmë të nderuar anëtarë të Kuvendit, kolektor dhe zgjerim i rrugës. Këtu po flasim për kolektorin i cili nuk është kryer. Është kryer pjesa anësore në të dy anët kurse kolektori ka me qenë në mes të rrugës.

Urim Suka - ti mund ti kryesh ato propozime sepse ke kryer edhe në 2023 dhe 2024 rrugë që nuk figurojnë në planifikim por shqetësimi im është që kur ne po e qojmë dorën për një vendim ju po e ndryshoni në zyrë.

Kryetari - ti i ke pa disa kontrata dy vjeqare. Kryhet në Bllacë për një muaj, mbyllet procesi dhe mbesin mjete. Nëse nuk i shpallim si po thua ti, duro edhe pak sepse ke kohë. Rruga që e lidh autostradën ka me u krye sepse vet i kemi kaluar hartat zonale e planin zhvillimor. Nëse e shkelim ligjin shkojmë para organeve të drejtësisë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**18 për, 11 kundër
Miratohet pika 2**

Kryetari - pyet nëse ka ndonjë pyetje për të sepse ka një obligim dhe i duhet të shkoj.

Liridon Fandaj - ka disa herë që e them që pikën pyetje dhe përgjigje me lënë si pikë të tretë që mos me ik as kryetari dhe as drejtorat sepse në fund po mbesim vetëm 10 veta. E kam pas një pyetje në asambleenë e kaluar për Kryetarin dhe Drejtorin e Financave. Kontrata me Ballkanin është nënshkruar prej 2018-tës dhe asnjë obligim nuk iu ka kryer komunës dhe ne si asamble i kemi nda 200 mijë euro për atë kompani.

Kryetari - janë përgadit shumë lëndë dhe jemi duke i dërguar te përmbartuesit. Edhe këtu e zbatojmë ligjin.

Liridon Fandaj - kontrata të obligon që nëse në vitin vijues nuk i ka kryer obligimet, ti duhet me shpëput kontratën dhe sot jemi në vitin 2024 dhe ti nuk e ke shpëput. Nëse është ligjore atëherë ti ke përgjegjësi.

Kryetari - ai nuk mund ti ik atyre mjeteve sepse ato nuk hiqen. Në një aspekt jemi mundu me stimuluar kulturën edhe sportin dhe ne çka kemi pas mundësi me i ndihmu Ballkanit, smund ti ndihmojmë më. Ai obligimit ndaj shtetit nuk mund ti ik.

Liridon Fandaj - është obligim ligjor që ty të obligon me shpëput kontratën.

Kryetari - për me dasht me shpëput kontratën duhet ta sjellim në Asamble.

Alban Berisha - më vjen mirë që janë marrë një shumë e mjeteve për shkak të performances.Më vje mirë që janë përmirësuar edhe ata të komisionit sepse kur po del dobët ata s'po janë në elemente të veta sepse vet je anku.

Kryetari - ne e kemi një problem te gjinia femërore.Në aspektin ligjor ne i plotësojmë të gjitha kushtet në pushtet por ne i marrim minus pikë për shkak se nuk kemi askund nëpër fshatra të caktuar kryetare të këshillave dhe kanë mbet afër 8 fshatra.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - në parim ne si LDK jemi që pronat publike që Komuna i ka në dispozicion është mirë me i kthyer në prona që sjellin zhvillim, me i dhënë në shfrytëzim.Jo domosdoshmërisht pronën gjithmonë me dhënë veq për ndërtim sepse mendoj që komuna ka nevojë edhe për hapësira tjera. Kur jemi te vendimi unë e kam pa pjesën e propozimit që ju e keni bërë dhe aty është një pjesë e hollë dhe e gjatë skaj rrugës dhe për mua ka qenë pak e çuditshme sepse ajo pronë pretendohet të jepet për ndërtim për faktin se ndoshta ka nevojë ndonjëherë qyteti me u zgjeru rruga por përtej kësaj ne nuk jemi kundër edhe për me ndërtu banesa apo objekte tjera.Nga materiali që na ka ardhë këtu shkruan që janë 29 ari dhe ne e japim pëlqimin për rreth 7 ari por nuk është e specifikune dhe unë nuk e di se cila pjesë ka me u marrë.Kur u bë ky propozim unë mendoj që nuk është përgadit si plan i mirë dhe nëse ne e votojmë kështu ndoshta ka mundësi me u keqinterpretu dhe keqpërdor dhe deri sa është kështu ne si LDK nuk e mbështesim një vendim të tillë.

Liridon Fandaj - është hera e dytë që në asamble na vje radhazi një vendim me kalu për të njetat prona përrreth aty. Cila është kjo urgjencë dhe cili është operatori ekonomik që e ka bërë kërkesë për këtë pjesë? Ne nuk e kemi një kërkesë të tillë. Kërkoj sqarime nga Drejtori i Urbanizmit.

Armend Krasniqi - Drejtori i Pronës jep sqarime dhe thotë që pronat të cilat inicohen për dhënie në shfrytëzim afatshkurt dhe afatgjatë,lista e publikimit të pronave komunale del në faqen zyrtare të komunës në dhjetor të çdo viti dhe aty parashihen se cilat prona jepen në shfrytëzim.Një ndër ato prona që i kemi paraparë është edhe kjo pronë e cila me destinim është destinim i lartë andaj si kërkesë që ka ardhë te drejtoria jonë e kemi pa të arsyeshme që kjo me u inicue në procedurë të rregullt dhe komuna me hy në bashkëndërtim me operatorët të cilët janë të interesuar të ndërtojnë ngjit me parcellën tonë.Drejtori tutje jep sqarime dhe gjithëashtu thotë që kemi dhënë edhe prona bujqësore.

Liridon Fandaj - atë listen që e kanë planifiku nuk e kemi pa ne.A është ajo pronë? dhe kërkesën e operatorit.

Armend Krasniqi - të gjitha pronat komunale janë të publikuara në listen e pronave për dhënie në shfrytëzim dhe po është ajo pronë.

Jehona Rrafshi - sa i përket kësaj parcele është afërsisht 29 ari dhe në shfrytëzim po jepen vetëm 7 ari.A ekziston mundësia dhe a është e drejtë që kjo parcelë të ndahet për gjysmë dhe mos të jepet në shfrytëzim e gjitha por vetëm një pjesë dhe a vlen edhe për parcelat tjera?

Armend Krasniqi - nga pjesa e parcelës e cila është 30 ari janë planifiku një zone 8 ari dhe një zonë tjetër 6 ari që me u zhvillu ndërtim.Do të thotë absolutisht lejohet ndarja.

Urim Suka - në vendim është e cekne që kanë me u nda por nuk është e specifikuar se në cilën.

Ti the që të gjitha pronat publike janë të publikuara në faqen e komunës.Nëse unë nuk gaboj pronat e komunës ti obligohesh me bërë një listë të veçantë me të cilat i ke prioritet me i dhënë për vitin 2024.A e ke bërë një planifikim për vitin 2024 se cilat prona ki me i dhënë në shfrytëzim,ku është destinacioni dhe a i ke publiku?

Armend Krasniqi - dy lista i kemi publiku dhe njëra ka qenë që i kemi publiku për me i dhënë për vitin 2024 por nuk do të thotë që pronat të cilat nuk janë të planifikuara me u dhënë për 2024 nuk kanë të drejtë me u marrë prej asaj listës që nuk janë të planifikune për 2024.Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - nuk u diskutu shumë dhe është me rëndësi ta dime se cili është interesi konkret i komunës?

Visar Kuçi - në këtë rast pronari i tokës kur është prona fqinje me këtë parcelle të komunës, kur do të ndërtojë diçka vjen te ne dhe konsultohet se çka i lejohet me ndërtu dhe si. Në këtë rast ne ia kemi sqaru pjesën e parcelës së tij por harta zonale thotë që parcela që është me minimumin e metrave katror që lejohet në hartë zonale, nuk duhet të dëmtohet por duhet të pyetet dhe në këtë rast jemi komuna. Ne nëse i japim leje ndërtimore pronarit që është ngjitur me një parcelle të komunës dhe komuna nuk mund të inkuadrohet në atë parcelle atëherë ne e kemi dëmtu pronën e komunës. Për ne është më mirë me vendos në publik për konkurim se sa me shfrytëzu dikush privat. Kjo bën pjesë në rrugën “Brigada 123”, është parcelle me 2900 m² dhe nga ajo sipërfaqe një pjesë është e planifikuar rrugë, një pjesë është zonë ndërtimi P+4, një pjesë tjetër është zonë ndërtimi P+8. Drejtori tutje jep sqarime. Votone secilën që vje sepse përfiton komuna.

Liridon Fandaj - nëse është interes dhe po mendojmë që është interes i komunës por a do të ishte mirë me atë pronarin me bë një këmbim siç është rasti te Bashkim Hoxha që mos me vendos në ankand publik sepse nëse e vendosim në ankand i jepet e drejta çdo kujt me konkuru. Nëse unë konkuroj dhe e marrë atë pjesë, a po i bie që unë po bëj pazare me pronarin privat tjetër nëse unë e marrë prej komunës 20% dhe po ia jap atij 30%. A po i bie që unë po fitoj me pronë publike? Realisht ashtu i bie.

Avni Bytyqi - ti mund ta marrësh por nuk ke të dejtë me ia dhënë dikujt tjetër sepse ligji e thotë që palës së tretë nuk ke të drejtë me ia dhënë në shfrytëzim.

Liridon Fandaj - nëse ajo është e kundërligjshme që nëse në atë pjesë 688 m nuk më lejohet ndërtim sepse nuk është kusht atëherë kjo është përgadit enkas për atë që ka bë kërkesë.

Visar Kuçi - sot ka ardhë ky dokument për me i inicuar procedurat, në një seance tjetër ka me ardhë kërkesa për formimin e komisionit dhe komisioni kur të formohet dhe kur ta publikon në ankand publik ka me i vendos kushtet bazuar sipas hartës zonale dhe konkurimi është i hapur për të gjithë dhe nëse ti aplikon me 688 m² mund të jesh bashkëinvestitor me këtë tjetrin. Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

17 për, 9 kundër, 1 apstenim
Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqur ofertuese, pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin për propozimet.

Laureta Tafaj - kërkoj më shumë sqarime. A na kanë ardhë disa ankesa për naj pronë që e kemi dhënë në shfrytëzim apo kemi me i prit ankesat për pronat e ardhshme? Ne po e bëjmë komisionin për ankesa para se me i bë komisionet për dhënie në shfrytëzim të pronave.

Avni Bytyqi - formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave që paraqiten kundër procesit të vlerësimit të pronave nga ana e komisionit është kategori ligjore, është e rregullune me ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme i cili komision ka mandat 2 vjeçar.

Urim Suka - komisioni paraprak a ka pas obligim me ia sjell një raport kuvendit se çfarë ankesa ka shqyrtu. Mendoj që secili komision e ka një obligim me i raportu kuvendit.

Avni Bytyqi - komisioni ka pas mandate 2 vjeçar dhe gjatë kësaj periudhe ka patur vetëm një ankesë dhe është refuzu ankesa.

Aziz Bytyqi - ne propozojmë Edon Sadikaj.

Alban Berisha - propozojmë **Shefket** Kolgeci.

Mevlud Kabashi - PDK propozon Sheqerije Zyrapi.

Laureta Tafaj - ne nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi - nuk kemi propozim.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryesuesi - ne i morëm propozimet dhe i hedhim në votim një nga një.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së për Edon Sadikaj.

21 për

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së për Shefket Kolgecin

13 për, 14 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e PDK-së për Sheqerije Zyrapin.

17 për, 1 apstenim

Kryesuesi - konstaton që nga kuvendi më të votuarit janë Edon Sadikaj dhe Sheqerije Zyrapin.

Nënkryetarja - nga ekzekutivi propozojmë Elona Buqa Kuçi dhe Shqipron Bytyqi ndërsa nga shoqëria civile propozohet Refki Zogaj.

Urim Suka - ne kemi diskutu edhe para dy viteve kur është formu ky komision dhe si duket prap nuk po merren parasysh ato vërejtje. Ne e dime që ju e keni shumicën dhe muni me vepru në këtë formë por është pak e çuditshme sepse për deri sa AAK dhe PDK janë në bashkëqeverisje ka qenë e udhës me qenë një kandidat i pushtetit dhe një i opozitës. Është mirë të reflektoni që herave tjera me pas parasysh këtë temë.

Kryesuesi - unë i përçolla të gjitha procedurat si është kërku.

Shefket Kolgeci - edhe kur ka fillu ky mandat dhe mandatin e kaluar e keni bërë të njëjtin. Kjo është autokraci dhe demokraci nuk është. Asnjë komision në mandatin tonë sidomos i pronave dhe i ankesave nuk ka qenë pa një kandidat nga opozita. Kjo është për keqardhje.

Armend Krasniqi - i nderuar doktor, në caktimin e komisioneve të cilat i kemi bërë disa herë herave të kaluara, kanë qenë pjesë e komisioneve një herë Elmazja, një herë Kushtrimi dhe një herë ke qenë ti dhe ti nuk ke ardhë asnjëherë në komisionin të cilin e kemi pas.

Shefket Kolgeci - anëtarët e juaj kanë dhënë dorëheqje sepse kanë qenë të pakënaqur, keni bërë diskriminim

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Edon Sadikaj, Sheqerije Zyrapin, Elona Buqa Kuçi, Shqipron Bytyqi dhe Refki Zogaj.

15 për, 8 kundër,

Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe ia jep fjalën Sanie Kuçi Rexhepaj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - një ndër qëllimet kryesore të grupit të grave është fuqizimi i grus në komunën tonë në bazë të kompetencave që na takojnë si kuvendarë. Ky propozim ka për qëllim konkret fuqizimin e gruas, e atë fuqizimin e gruas në pronë. Komuna e Suharekës që nga viti 2019 legalizon ndërtime pa leje në bazë të ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe që nga atëherë në Komunën tonë vetëm një shtëpi është legalizuar dhe regjistruar në bashkëpronësi burrë dhe grua dhe 16 objekte të tjera janë legalizuar në emër të grave. Këto statistika të ulëta na kanë nxitur neve të ndërmarrim dhe të propozojmë masë afirmative që liron nga pagesa e legalizimit si taksë komunale të gjitha shtëpitë që aplikojnë për legalizim në bashkëpronësi burrë dhe grua dhe të gjitha shtëpitë në emër të grave. Sanie Kuçi Rexhepaj si kryetare e grupit të grave tutje elaboron këtë pikë dhe në emër të grupit të grave kërkon mbështetje për këtë projekt-vendim.

Selman Kolgeci - nisma e grupit të grave mendoj që është e mirëseardhur sepse përpos që stimulon që ndërtimet të regjistrohen në bashkëpronësi po ashtu stimulon që të kemi sa më shumë aplikime për legalizim të objekteve pa leje. Po ashtu pika 11 e nenit 20 të ligjit për trajtimin e ndërtimit pa leje e precizojë saktë, citoj pikën 11: me vendimin e kuvendit komunal, komunat mund të caktojnë taksa që janë më të ulta se taksat e caktuara në këtë nen ose të lirojnë kategoritë tjera nga pagesa. Andaj me qëllim që sa më shumë qytetarë ta shfrytëzojnë të drejtën e legalizimit të objekteve pa leje dhe në mbështetje të ligjit respektiv dhe ndryshimeve të këtij ligji propozoj që të lirohen nga taksa për legalizim pa leje të gjitha kategoritë, objektet e të cilave verifikohen në ortofoto nga viti 2004 deri në vitin 2018.

Flamur Bytyqi - te vendimin thote qe te gjitha grate dhe te gjithë aplikuesit,a nënkupton qe nuk është vetëm për gra?

Avni Bytyqi - vlen edhe për burrat qe pronën e qesin në bashkëpronësi me gruan.

Urim Suka - falemderoj grupin e grave për iniciativat qe ndërmerr dhe qe shumica janë të qëlluara.Ne i kemi mbështet por për procedure të hedhet në votim propozimi i Selmanit së pari.

Avni Bytyqi - para 2018-tës janë të liruar.

Selman Kolgeci - prej 2004 deri në vitin 2018 mund ti legalizosh,pas 2018 me leje ndërtimore dhe para 2004 veq janë të liruar.Për këtë periudhën e njëjtë qe e ka kërku grupi i grave,ne po kërkojmë qe të lirohen të gjithë qytetarët.

Sanie Kuçi Rexhepaj - mos të largohemi nga qëllimi kryesor i këtij projekt-vendimi.Nuk është vetëm taksa qe po lirohet si qëllim i këtij projekt-vendimi por është fuqizimi i gruas në pronë.Nëse e largojmë totalisht taksën atëherë prap legalizojmë vetëm në emër të burrave për shkak se po lirohen të gjithë dhe qëllimi është qe me u fuqizu gruaja në prone.

Selman Kolgeci - unë e qmova këtë nismë qe përpos qe stimulon me pas objekte në emër të grave ose në bashkëpronësi,e stimulon me pas edhe kërkesa për legalizime më shumë.Me qenëse u dha arsytimi qe po duan ta fuqizojnë rolin e gruas por me sa kam informacione edhe burrat nuk janë duke apliku.Vetëm në vitin 2024 janë 30 aplikacione qe janë për legalizimin andaj ne e tërheqim propozimin tonë dhe e shtyejmë për një seancë tjetër.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne i propozojmë qe jo me largu komplet taksën por të paktën me liru sepse edhe Komuna ka nevojë për të hyra.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2034;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - falemderoj ekipin i cili ka punuar në këtë plan dhe i përgëzoj të gjithë ata qe kanë dhënë një kontribut qe komuna jonë të ketë një plan të mobilitetit për periudhën 10 vjeqare dhe qe prek shumë tema me interes,qoftë për sigurinë e këmbësorëve,qoftë për trajtimin e parkingjeve,trajtimin e çiklistëve,trajtimin e problemeve në transportin publik,trajtimin e problemeve dhe rekomandimeve për lëvizjen e automjeteve në mënyrë të sigurtë dhe komode me qëllim të rritjes së nivelit të shërbimit për kryqëzime të caktuara.Dua ti kujtoj qeverisjes Muharremaj dhe dua ti njoftoj të gjithë qytetarët tanë se plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban për komunën tonë ka qenë pjesë e rëndësishme e programit tonë zgjedhor por nuk ka të keqe qe e ka kopju Kryetari Muharremaj.Kjo veq se do të jetë në shërbim të lehtësirave për qytetarët dhe në shërbim të qytetit funksional.Ky dokument qe sot po e trajtojmë shpërfaq në mënyrë të detalizuar dobësitë e qeverisjes Muharremaj,shpërfaq realizimin e punëve shkel e shko,shpërfaq keqmenaxhimin e parasë publike qe e ka bërë qverisja Muharremaj qoftë për trajtimin e rrugëve e nyjeve të komunikacionit,qoftë për ofrimin e sigurisë për ngasësit,këmbësorët e çiklistët e rrejdhimisht shpërfaq mungesën e trajtimit të pikave me rrezikshmëri të lartë dhe komunikacion kur dihet dhe jemi dëshmitar të shqetësimit nacional për numrin e madh të aksidenteve qe po ndodhin në rrugët tona.Përpos kësaj ky dokument vërteton dhe ju jep të drejtë kritikave tona qe i kemi ngritur në këtë kuvend e kudo ku kemi pas mundësi në lidhje me realizimin e punëve pa planifikim të mirëfillt,në lidhje me realizimin e investimeve pa projekte detale e në kundërshtim me çdo normë teknike,në kundërshtim n'çdo kriter minimal të sigurisë në komunikacion.Një dokument të tillë ne do ta përkrahim dhe shpresoj qe ky dokument i rëndësishëm të merr miratim nga ky kuvend si dhe shpresoj qe rekomandimet qe kanë dalë nga ky dokument të implementohen në mënyrë qe të arrihet qëllimi i hartimit të planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban,në atë mënyrë qe të ofrohen kushte më të mira e më të sigurta për ngasësit e automjeteve,të ketë parkingje të mjaftueshme,të sigurta,të lehta dhe të qasshme e të shpërndara në zona sipas rekomandimit të këtij dokumenti.Kujtojmë qe gjobat më të mëdha në qytetin tonë janë gjobat për kundërvajtësit të cilët parkojnë automjete e tyre në vendet jo adekuata për shkak se nuk kanë vende të

caktuara. Po ashtu të ketë shpërndarje më të madhe të çiklistave, parkingje të mjaftueshme për to e inkujarim i përdorimit më të madh të biçikletave me qëllim të zëvendësimit me mjete motorike. Të stimulohet ecja në këmbë e të stimulohet përdorimi i transportit publik që normalisht përpos zvogëlimit të numrit të përdoruesve të automjeteve privat, do të ndikojë edhe në zvogëlimin e emetimit të gazrave në natyrë. Uroj që ky dokument të mos ketë fatin e shumë dokumentacioneve tjera që miratohen nga ky kuvend e zbatim nuk gjejnë.

Visar Kuçi - fillimisht e falemderoj UNDP-në, kompaninë që e ka përzgjedh hartimin e këtij dokumenti. Ne i kemi ndjek të gjitha procedurat si grup punues ku jemi nda në tre grupe. Drejtori i Urbanizmit tutje elaboron procesin e punës sa i përket planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban.

Selman Kolgeci - besoj që drejtori Kuçi e ka keqkuptu atë që e thashë unë. Unë e dhashë vlerësimin maksimal për këtë dokument dhe duke e ditë rëndësinë e tij. Ajo që nuk i ka pëlqy është që ne përherë kemi kërku një dokument të tillë por brenda këtij dokumenti ke edhe rekomandime për investime që janë bërë, qoftë kyqje në rrugë e qoftë rrethrotullime, shteg të çiklistave që nuk janë respektu normat teknike kur janë ndërtu ato. Andaj ne përherë kemi thënë që ti je duke bërë investime pa projekte dhe unë aty u lidha. Te pjesa e ftesës unë personalisht nuk kam marrë asnjë ftesë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Me 21 vota për Miratohet pika 6

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - mbledhjen e kaluar kam kërku nga drejtori i shërbimeve publike me i sjell përgjigjet në seancën e ardhshme por pasi nuk janë drejtorat s'kam pyetje.

Urim Suka - është pak e pakuptueshme për shkak se ne nuk e kemi fare ekzekutivin këtu por besoj që legjislativi e merr për obligim që pyetet që ne po i bëjmë me i adresu te secila drejtori dhe me mujt të paktën mbledhjen e ardhshme me pas përgjigjen adekuate për secilin shqetësim që ngrisim. Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ditë më parë kam pranuar një shqetësim qytetar lidhur me rrugën "Sali Shabani" në Suharekë. Sipas qytetarëve në këtë rrugë nga fundi i vitit është bërë një investim në rregullimin e ujësllësit. Gjatë punimeve është dëmtu rruga mirëpo edhe pse kanë kalu 5 muaj apo më shumë gjendja e rrugës është për keqardhje dhe gati është bërë e pakalueshme. A jeni në dijeni për këtë problem dhe kur pritet të rregullohet kjo rrugë? Ndërkohë më lejoni të ju informoj se në këtë lagje edhe rrugët "Fan Noli, Milit Kryeziu, Adem Kuçi, Migjeni" etj. Janë tash e një kohë pothuaj të pakalueshme ndërkohë që ju keni zgjedh të investoni në lagjen "Slllogja" ku të paktën rrugët atje kanë qenë në gjendje të mirë se për këto që po flas unë. Çli është plani juaj për rregullimin e këtyre rrugëve për vitin 2024? Gjithëashtu një shqetësim tjetër është edhe rregullimi i shtigjeve për biçikleta. Pushteti juaj vite më parë pat vendosur një shirit me ngjyrë të kuqe nëpër një pjesë të trotuarit në qytet si shteg për biçikleta e cila ngjyrë për një kohë shumë të shkurtër është dëmtuar. Ndërkohë vitin e kaluar ju keni pre një pjesë të rrugës dhe keni shtruar me asfalt këtë shirit por ende nuk e keni përfundu fazën finale për përfundimin e shtegut për biçikleta. A mund të më njoftoni se pse nuk është përfundu ende ky projekt dhe kur pritet finalizimi i tij? Shqetësim tjetër është tek hapësira mes muzeut, fushës së futbollit "Ballkani" dhe shkollës "7 Marsi". Kjo hapësirë është tejet e dëmtuar dhe qytetrët që frekuentojnë këtë hapësirë detyrohen të kalojnë çdo ditë nëpër ato gropa. Kur pritet të rregullohet kjo hapësirë dhe të evitohet ky problem?

Liridon Fandaj - e përgëzoj drejtorin e Pronës për veprimin që e ka marrë për lirin e pronave publike. Cilat janë procedurat për obligimet e pronarëve që kanë qenë jo legjitim deri tash. Një kontratë i ka skadu në 2017 e ata kanë vazhdu prap ti shfrytëzojnë ato prona. Kur do ta lironi edhe tregun ku disa bujq e qytetarë tonë shkojnë në treg dhe i paguanë një taksë një pronari jo legjitim që i ka kalu kontrat dhe e ka një obligim deri në 60.000€ në komunë. Ata detyrohen me pagu 5€ e ai nuk e kryen obligimin ndaj komunës. E përgëzoj për veprimin por i kisha thënë që mos të ndalet dhe ti lirojë të gjitha pronat publike te ata pronarë që nuk i përgjigjen kuvendit komunal.

Armend Krasniqi - faktikisht ashtu siq thatë edhe ju, ne muajt e fundit kemi marrë iniciativa që ti lirojmë shumë prona publike dhe jemi duke vazhduar të punojmë e të analizojmë çdo detaj dhe ata qytetarë të cilët nuk i përmbahen kontratave mes komunës dhe atyre të cilët i kanë nënshkruar, shumë shpejtë do të

merren masa ligjore dhe të gjithë ata që nuk janë në rregull çoftë me pagesa e çoftë me mospërbushje të kontratave të cilat vet i kanë nëshkruar, do ti lirojnë pronat e uzurpuara. Vetëm këtë vit kemi më shumë se 30 prona të liruara nga komuna e Suharekës. Sa i përket tregut edhe te ky operator ekonomikë ka disa mos përbushje të kontratës dhe shumë shpejt edhe aty do të merret një vendim.

Flamur Bytyçi - sa është obligimi total i këtyre që nuk kanë pagu dhe a keni ndonjë listë? A keni inicu ndonjë procedure ligjore për këta persona të cilët nuk iu kanë përmbajtë kontratës?

Armend Krasniqi - kjo nuk është kompetencë e drejtorisë time mirëpo sa jemi të informuar kemi borgje të pa inkasuar që nga viti 2000 kur qytetarët kanë lidhur kontrata me komunën dhe këto borgje patjetër që duhet të inkasohen nga Drejtoria e Financave apo kushdo të është kompetentë. Ligji është në fuqi dhe besoj shumë shpejt do të fillojnë të zbatohen edhe procedurat e përmbarimit.

Flamur Bytyçi - a keni inicu ndonjë procedurë për këta që janë deri tash.

Armend Krasniqi - procedurat për inkasimin e borgjeve nuk inkasohen nga drejtoria jonë mirëpo inkasohen nga Drejtoria e Financave. Sipas kontakteve që kemi me këtë drejtori shumë shpejt të gjithë ata të cilët nuk i përmbahen obligimeve që kanë ndaj komunës do të merret procedure për inkasimin e këtyre borgjeve që kanë ndaj komunës.

Urim Suka - duke inkuraju drejtorin që të gjithë ata që kanë obligime ndaj komunës, të veprojnë dhe të marrë masa mirëpo unë dua të lidhem te çështja e fundit e banesave. Nuk është për mua e njëjtë sikur me largu dikënd prej banesës pse ka borgj dhe që e ka jetike jetesën dikund dhe në anën tjetër ti me lënë një biznes që përfiton prej asaj. Ai ka obligime dhe atë nuk e ke hek e këndeje familjarët i ke hek prej banesave. Nuk e them që nuk ke të drejtë sepse nëse kanë obligime ata duhet me i përmbush por mos e trajto njëjtë çështjen. Të paktën me qenë më të kujdesshëm te pjesa e shfrytëzimit të banesave dhe nuk e them që nuk e keni bërë.

Armend Krasniqi - kemi vepruar sipas ligjeve në fuqi dhe çdo ankesë apo çdo gabim i joni nëse është bërë, mund të drejtohet dikund tjetër. Apsolutisht i kemi dhënë maksimumin e kohës të cilën e kanë pas në dispozicion, jo vetëm unë po të gjitha qeveritë e kaluara mirëpo ka ardhë një fund që disa gjëra duhet të vendosen në vend.

Takimi përfundoi: 15:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj